

Asociacioni i Komunave me shumicë Sërbe – Çka dimë deri tash?

Krijimi i Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe ishte një komponentë kyçe për Qeverinë e Serbisë në Marrëveshjen e Brukselit për Normalizim të Prillit 2013 dhe qështja kryesore që e ka vonuar nënshkrimin e marrëveshjes.

Krijimi i saj varej nga pjesëmarrja e komunave veriore në zgjedhjet lokale të mbajtura në tërë Kosovën në Nëntor 2013. Ato zgjedhje janë mbajtur, sikurse janë mbajtur edhe zgjedhjet parlamentare këtë vit por Asociacioni nuk është krijuar. Gjate fushatës për të dy këto zgjedhje Asociacioni nuk ka qenë çështje kyçe. Pse?

Le të shohim së pari se çka duhet të jetë ky Asociacion. Kjo nuk është e lehtë. Një lexim i Marrëveshjes së Brukselit nuk do të na ndihmoj shumë. Marrëveshja fillestare – duket se nuk ka marrëveshje të nënshkruar – është përpiluar në anglisht që duket se ka mungesa. Marrëveshja thekson se do të ketë një “Asociacion/Bashkësi të Komunave me shumicë Serbe”, me anëtarësi të hapur për “cilëndo komunë tjetër”. Asociacioni do të krijohet me statut dhe strukturat e tij, siç theksohet në Marrëveshje, duhet të bazohen në statutin e Asociacionit të Komunave të Kosovës¹ në të cilin do të jenë anëtare edhe katër komunat veriore.

Një Ekip Menaxhues, i ngarkuar me “të gjitha çështjet e themelimit të Asociacionit”, u prezantua në Bruksel në Qershor 2013, ku të gjithë anëtarët ishin të caktuar nga Beogradi. Ekipi ende nuk ka paraqitur një draft të përgatitur për themelimin e këtij trupi. Në anën tjetër, Ministria Kosovare e Pushtetit Lokal dhe Administratës (MPLA), ka hartuar një draft statut dhe ia ka dërguar palës Serbe në Dhjetor, por nuk ka marrë përgjigje. Në Gusht, pala Serbe tha se është duke e hartuar një statut.

Asociacion/Bashkësi

Marrëveshja e Brukselit përdori dy terma për të njejtin institucion: bashkësi dhe asociacion. Pse? Kjo mund të jetë rezultat i gjuhës së legjislativit Kosovar. Ligji i Kosovës e përdor termin asociacion dhe ndërrimi i termit në “bashkësi” mund të kërkoj një procedurë tjetër ligjore.

Kjo gjithashtu mund të reflektoj ndjeshmëri politike nga ana e Prishtinës që sipas të gjitha gjasave zë fill në krijimin e bashkësisë të komunave në Bosnje dhe Hercegovinë dhe ish Jugosllavi që gjithashtu quheshin Bashkësi (Zajednica). Një e tillë ishte Bashkësia Kroate e Herceg-Bosnjes që kërkonte të krijonte një “tërësi politike, ekonomike, kulturore dhe territoriale” në territorin e Bosnje dhe Hercegovinës. Marrëveshja cakton se shpërbërja e saj mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse.

Asociacioni duke qenë i komunave me shumicë Sërbe do të kishte përfaqësues nga Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveqani, Zubin Potoku, Shtërpca, Graçanica, Parteshi, Novo Bërda, Raniluka, dhe Klllokoti. Anëtarët gjithashtu duhet të vinë edhe nga komunitetet tjera në ato komuna, kështu që ai nuk do të përfaqësonte vetëm serbët. Një Asociacion i bazuar në statutin momental të Komunave në Kosovë do të kishte një asamble, një kshill dhe një bord. Anëtarët e Kuvendit nuk do të zgjidhen direkt por do të delegohen nga këshilltarët komunal të cilët zgjidhen direkt. Prandaj ajo do të kishte

¹ <http://komunat-ks.net/wp-content/uploads/2011/11/Statuta-Asocijacija-Kosovskih-Opstina.pdf>
<http://komunat-ks.net/wp-content/uploads/2011/11/Statute-of-AKM.pdf>

rreth 20 anëtarë. Kshilli përbëhet nga kryetarët e komunave dhe anëtarëve të bordeve. Bordi ka kryetarin, nenkryetarin, dhe 5 anëtarë të zgjedhur nga kuvendi.

Roli dhe përgjegjësitë

Marrëveshja nuk specifikon se Asociacioni do të ketë rol ekzekutiv, por plotësisht reprezentativ me një funksion (të padefinuar) monitorues. Duket të jetë një trupë këshilluese dhe mbështetëse, më shumë si një dhomë diskutimesh ku komuniteti Serb do t'i ofroj idetë dhe pikëpamjet e tyre te qeveria lokale dhe qendrore. Sipas Statutit të Komunave të Kosovës, Asociacioni takohet vetëm një herë në vit, por teorikisht nuk ka ndonjë pengesë që keto takime të mbahen më shpesh. Kjo trupë ka një varg të gjërë aktivitetesh duke përfshirë këshillime dhe marrjen e iniciativave për hartimin e ligjeve.

Do t'i jepet një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve siç është definuar në marrëveshjen në gjuhën angleze që është në kuadër të Zyrës së Presidentes. Ky trup është themeluar në vitin 2008 dhe veç ka pesë anëtarë nga komuniteti Serb, po ai duhet të jetë akoma më efektiv dhe efikas. Së fundmi, Marrëveshja e Brukselit thekson se fushat e përgjegjësive të Asociacionit janë: shëndetësia, edukimi, zhvillimi ekonomik, planifikimi urban dhe rural.

Në Janar, Ljubomir Maric, një anëtar i Ekipit Menaxhues, tha se ata synojnë që t'i japin Asociacionit sa më shumë fuqi që është e mundur dhe dihet se pala Serbe do të dëshironte t'i jipte fuqi ekzekutuese. Megjithatë kjo nuk është ajo që janë marrë vesh në Bruksel edhe pse parapgrafi i 5-të i Marrëveshjes thekson: Asociacioni/ Bashkësia do të ushtroj kompetenca shtesë që do t'i delegohen nga autoritetet qendrore. Nuk thekoshet cilat autoritete qendrore dhe kjo pikë do të thoshte se iniciativat do të vinin nga niveli qendror e jo ai komunal.

Përderisa nuk ka pasur përparim në zhvillimin e këtij trupi, thashetheme të ndryshme kanë qarkulluar. Kur u paralajmëruan zgjedhjet parlamentare në fillim të Majit, doli çështja e ulëseve të rezervuara në Parlament për minoritetin Serb dhe minoritetet tjera. Komuniteti Nderkombëtar u raportua të ketë thënë se skadimi i ulëseve të rezervuara do të nënkuptonte se Asociacioni do të kishte më shumë fuqi dhe se kjo i ishte sqaruar liderëve Kosovar gjat negociatave. Keto definime ngritën pritshmëri të pabaza dhe krijuan keqkuptime.

Krijimi i asociacionit, kuptohet, është politizuar tej mase dhe kjo është arsyeja kryesore pse ka vonesa në themelimin e tij. Përderisa nuk krijohet ky asociacion, komuniteti Serb po privohet nga një zë të cilin ua garanton Marrëveshja e Brukselit.

Gusht 2014